



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 18 Maj 2021

Nr. 360

VENDIM

Objekt: Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj Akademisë së Sigurisë.

Kërkues: Z. Myzafer Elezi

Ndaj: Akademisë së Sigurisë

Baza ligjore: Nenet 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe ‘n’, pika 2 dhe 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 60, 61 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

VËREN:

I. Vlerësimi paraprak

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve më datë 31.3.2021, është raportuar një kallëzim në e-mail denoncime.kqz@gmail.com, nga z. Myzafer Elezi, administruar në KQZ me nr. 3182 prot., datë 3.4.2021, i njëjti denoncim është përcjellë nga Institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë, i cili është



administruar në KQZ me nr. 3701 prot., datë 13.4.2021, për shkelje të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Sipas denoncuesit pretendohet se: *“Më urdhrin nr. 1/353, datë 29.3.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, në Akademinë e Sigurisë, pritet të fillojnë studimet rreth 461 kursantë. Pasi i lanë në pritje për rreth 5 muaj, ditën që filloi fushata elektorale, pritet që më datë 6.4.2021 të fillojë Akademinë ky kontingjent kaq i madh njerëzish edhe pse nuk janë kushtet, kjo sepse Instituti i Ndërtimit si rezultat i tërmeteve të vitit 2019, me akt konstatimi të datës 19.3.2021 ka nxjerrë të pabanueshme mbi gjysmën e ambienteve të Kolegjit Arsimor. E njëjta situatë është dhe me konviktet e kursantëve”.*

Sipas përcaktimeve të neneve 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk i’a njuh shprehimisht Rregullatorit apo Kas-it.

Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se të dhënat e paraqitura nga denoncuesi, përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

II. Rrethanat e faktit

Komisioni Rregullator në KQZ me datë 24.12.2020 ka miratuar vendimin nr. 9 “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Sipas përcaktimeve të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator “Veprimtari publike”, janë të gjitha



veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut, apo të medias në kuptim të pikës 1 të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, të kryera nga subjektet e përcaktuara në këtë vendim, si dhe ato që kanë në agjendë informimin e publikut rreth tyre në periudhën katër mujore para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

➤ Referuar denoncimit të mësipërm, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 4276 prot., datë 22.4.2021, ka kërkuar informacion në lidhje me këtë veprimtari Akademisë së Sigurisë.

Me shkresën nr. 173/1 prot., datë 4.5.2021, administruar në KQZ me numër 4276/1, datë 5.5.2021, z. Bilbil Memaj, Drejtori/Rektori i Akademisë së Sigurisë ka dhënë pretendimet e tij duke sqaruar se:

“Referuar nenit 37/1, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, Akademia e Sigurisë është institucioni arsimor përgjegjës për formimin, specializimin dhe kualifikimin e punonjësve të strukturave të Policisë së Shtetit të nivelit operues, administrativ dhe menaxherial. Në ushtrim të detyrave dhe funksioneve të parashikuara në aktet ligjore dhe aktet nënligjore mbi të cilat Akademia e Sigurisë kryen veprimtarinë e saj, me urdhrin nr. 629, datë 10.7.2020 ka shpallur aplikimet për konkurrim për pranimin në Kolegjin Profesional të Formimit Policor.”

III. Analiza ligjore

Neni 3, pika 1.3, shkronja “d” i Vendimit nr. 9/2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve” të Komisionit Rregullator ka përcaktuar se “veprimtari të ndaluara”, janë dhe ato veprimtari që përfshijnë:

“gjatë fushatës zgjedhore, marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, shtesat në organikën e çdo institucioni publik e shtetëror apo emërime provizore, me përjashtim të rasteve të përligjura. Konsiderohen raste të përligjura rastet kur lëvizja apo lirimi nga puna vjen si rrjedhojë e shkeljeve, sipas legjislacionit përkatës, ose marrja në punë bëhet brenda strukturës dhe organikës në fuqi përpara fushatës zgjedhore nga institucioni apo enti publik në përmbushje të misionit të tij. Bëjnë përjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë”.

Referuar sa më sipër ndalimi lidhet vetëm në rastet e përcaktuara në kuptim të përkufizimeve të shkronjës “d”, pika 1.3, të nenit 3, të vendimit 9/2020, dhe kjo veprimtari kryhet nga subjektet e përcaktuara në nenin 3, të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.



Nga provat e vëna në dispozicion nga denoncuesi nuk u provua se kemi të bëjmë me veprimtari publike të ndaluar në kuptim të nenit 3, pika 1.3, shkronja “d”, të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në vlerësim të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ, konstaton se, nuk rezultoi e provuar se Akademia e Sigurisë është në shkelje të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në KQZ për këto arsye:

1. Procesi i pranimit në shkollimin bazë policor, ka filluar që në muajin korrik 2020, por për shkak të kohës relativisht të gjatë që kërkonte secila prej fazave të procesit, konkurrimi zgjati në kohë. Në ushtrim të detyrave dhe funksioneve të parashikuar në aktet ligjore dhe aktet nënligjore mbi të cilat Akademia e Sigurisë kryen veprimtarinë e saj, me urdhrin nr. 629, datë 10.7.2020 ka shpallur aplikimet për konkurrim për pranimin në Kolegjin Profesional të Formimit Policor. Pas verifikimit të dokumentacionit përkatës të aplikantëve, janë zhvilluar fazat e mëtejshme të këtij procesi, si: testi me shkrim, testi fizik, intervista me gojë, testi psikologjik, kontrolli mjekësor dhe marrja e gjurmëve daktiloskopike. Pas verifikimit përfundimtar, aplikantët e shpallur fitues janë pranuar në kursin e shkollimit bazë policor. Kohëzgjatja e këtij programi është 9 muaj, nga të cilat program teorik 6 muaj dhe praktika në terren 3 muaj. Në datën 6.4.2021, në Akademinë e Sigurisë ka filluar kursi XV-të për “Patrullë e Përgjithshme”, me pjesëmarrjen e 461 fituesve në procesin e konkurimit për pranimin në Kolegjin Profesional të Formimit Policor.
2. Shtetasit e pranuar në Kursin XV-të për “Patrullë e Përgjithshme”, nuk janë rekrutuar në Policinë e Shtetit, por janë pranuar në Akademinë e Sigurisë, me statusin “kursant”. Statusi “kursant”, nuk është status i një marrëdhënie pune, por statusi i personave që janë shpallur fitues nga një procedurë konkurrimi, të cilët ndjekin shkollimin bazë policor, deri në përfundim me sukses të programit të studimit, emërimit në detyrë dhe nënshkrimi i kontratës individuale të punës.
3. Referuar neneve 145 dhe 147 të Rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015, kursantët që përfundojnë me sukses programin e shkollimit bazë policor, pranohen në Policinë e Shtetit dhe emërohen në detyrë, duke nënshkruar kontratën e punës me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Ky është akti që përcakton lindjen e marrëdhënieve të punës dhe pasojave juridike, akt që do të ndodh në përfundim të programit mësimor nëse kursanti vlerësohet pozitivisht.

Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të vazhdojë shqyrtimin administrativ, për kallëzimin e kryer nga denoncuesi, pasi në përfundim të hetimit administrativ rezulton se, veprimtaria e Akademisë së Sigurisë nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve



të përcaktuara në dispozitat e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, pika 2, 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

V E N D O S:

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të kallëzimeve ndaj Akademisë së Sigurisë pasi nuk konstatohen shkelje të dispozitave të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 18 Maj 2021
Nr. 360

Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj Akademisë së Sigurisë.